



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM – ERZEN TIRANË

Nr. 2367/5 Prot.

Tiranë, më 03.10. 2019

VENDIM

Nr. 14 Datë. 20.09. 2019

PËR

MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË PËRDORIMIT TË BURIMIT UJOR, "MIRATIM NË PARIM, PËR PRODHIM HIDROENERGJIE", TË PELLGUT UJËMBLEDHËS TË LUMIT ERZEN, FSHATI VAKUMONE, BASHKIA TIRANË, PËR SUBJEKTIN "EGI-K" sh.p.k

Në zbatim të ligjit nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" i ndryshuar, përkatësisht neni 42 pika 3, neni 50 pika 2, neni 52 gërma c, të vendimit nr.416, datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes, për përdorim të burimeve ujore", të vendimit nr.822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", neni 24 gërma f, ndryshuar me vendimin nr.718, datë 12.10.2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", të vendimit nr.221 datë 26.04.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", të vendimit nr.6, datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", neni 11 pika 3 dhe vendimit nr.6, datë 12.06.2019 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor", me propozim të Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen-Mat, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

VENDOSI:

1. Miratimin e "Autorizimit të përdorimit të burimit ujor, miratim në parim, për prodhim hidroenergjie" për ndërtimin e HEC "DUSHKU", për subjektin "EGI-K" sh.p.k, me të dhënat si më poshtë:

Koordinatat e veprave të marrjes (*sistem koordinativ KRRGJSH*)

- Vepra e marrjes 1/1 X 505116.15; Y 4571352.62; Z 720 m
- Vepra e marrjes 1/2 X 505100.22; Y 4570940.53; Z 730 m
- Vepra e marrjes 2 X 505297.14; Y 4570618.47; Z 805 m

- Godina centralit (pika e shkarkimit) X 503416.40, Y 4570994.52, Z 570 m

Të dhënat për prurjet

- Prurja mesatare $Q_{mes.} = 0.275 \text{ m}^3/s$
- Prurja e ujit për përdorim $Q_{llog.} = 0.509 \text{ m}^3/s$
- Prurja ekologjike $Q_{ekologjik} = 0.0132 \text{ m}^3/s$
- Vëllimi i rrjedhës së kthyer $Q_{shkarkimit} = 0.509 \text{ m}^3/s$
- Trupi uJOR pritës Përroi Vakumone, Lumi Erzen

2. Në fazat e tjera, përpara miratimit të projektit të zbatimit, subjekti duhet të konsultojë projektin me Bashkinë e Tiranës me qëllim mbrojtjen e veprave ujitëse ekzistuese dhe respektimin e nevojave për ujitje për periudhën 15 Maj-15 Shtator.

3. Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Anastasi Meçi



KRYETAR

Suzana Jahollari

